MANUAL

Përdorimi i modelit “CIAO”

për të përmirësuar mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve

CIAO

Competencies **I**sland **A**dvancement **O**rientation

Nëntor 2021

Përgatiti:

Dr. Aida **Goga**
Dr. Brunilda **Zenelaga**
Dr. Marisa **Kërbizi**

Ky manual u realizua në kaudrin e nismës “Përdorimi i modelit ‘CIAO’ në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve”,zbatuar nga Shoqata për Trashëgimi dhe Edukim, Instituti “Master Thinker” dhe mbështetur ngaTerre Des Hommes Albania dhe Child Hub.

MIRËNJOHJE

Ky manual nuk do të mund të realizohej pa mbështetjen e Terre des Hommes Albania dhe Child Protection Hub. Gjithashtu një mirënjohje e madhe për të gjithë fëmijët që morën pjesë në këtënismë:

1. Adea Çerma
2. Anaroza Majko
3. Asel Çollaku
4. Bora Zeka
5. Darvin Kapciu
6. Ema Varaku
7. Ester Shëngjergji
8. Etjen Mehmetaj
9. Hana Shehu
10. Ilva Sakollari
11. Irja Çerma
12. Keitin Kapciu
13. Kristel Shyti
14. Livia Kaçi
15. Livia Shëngjergji
16. Lura Shehu
17. Matias Tomori
18. Mishel Isteri
19. Najeli Shyti

Një falenderim i veçantë për të gjithë prindërit, të cilët treguan vullnet dhe mbështetje të vazhdueshme përgjatë zbatimit të nismës.
Falenderojmë gjithashtu mësuesit, të cilët nëpërmjet dy webinareve që u zhvilluan përgjatë kësaj nisme, ndihmuan me idetë e tyre në hartimin e këtij manuali.

PËRMBAJTJA

Hyrje **5**

Kujt i shërben ky manual? **6**

Pjesa e Parë:Të Njohim Modelin Ciao dhe Konceptin e Mirëqenien Socio-Emocionale **7**

1.1 Ç'është modeli CIAO? 7

1.2 Të njohim konceptin e mirëqenies socio-emocionale 9

1. Kompetencat kyçe dhe rëndësia e zhvillimit të tyre 14

Pjesa II: Ushtrime Praktike Si mund të ndikojë Modeli Ciao në Mirëqenien Socio-Emocionale? Puna me fëmijët **20**

2.1 Ushtrime Praktike: Kompetenca Komunikimit dhe të Shprehurit 20

2.2 Ushtrime Praktike: Kompetenca e të Menduarit 23

2.3 Ushtrime Praktike: Kompetenca e të Mësuarit për të Nxënë 26

2.4 Ushtrime Praktike: Kompetenca për Jetën, Sipërmarrjen dhe Mjedisin ..29

2.5 Ushtrime Praktike: Kompetenca Personale 33

2.6 Ushtrime Praktike: Kompetenca Qytetare 36

2.7 Ushtrime Praktike: Kompetenca Digjitale 39

PJESA III: Mësime të nxjerra nga nisma **42**

3.1 Si u zbatua nisma "Përdorimi i modelit 'CIAO' për përmirësimin e ishujve të kompetencave të fëmijëve"? 42

3.2 Disa sfida të hasura dhe mënyra për t'i kapërcyer ato 43

Shtojca 1 ..... **45**

Shtojca 2:Ylli i Vetëvlerësimit **47**

Shtojca 3: Vlerat e Mia **48**

Referenca **49**

Hyrje

Gjatë dy viteve të fundit, mirëqenia e fëmijëve, veçanërisht në disa zona të Shqipërisë, është cënuar nga dy dy faktorë të paparashikuar: tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe situata e krijuar nga pandemia COVID 19. Studimet psikosiologjike kanë treguar se mirëqenia socio-emocionale e fëmijëve ndikon shumë në aftësinë e tyre për të fituar kompetenca të reja, për t'u zhvilluar nga pikëpamja shoqërore, për të ndërtuar vetëbesimin dhe për të arritur potencialin e tyre të plotë. Familjet dhe prindërit kanë qenë dhe janë ende të papërgatitur për t'u marrë me këto situata, veçanërisht në lidhje me fëmijët e tyre. Nga ana tjetër, institucionet arsimore nuk kanë qenë në gjendje t'i përmbushin plotësisht qëllimet e tyre. Mësimi on-line dhe koha e shkurtër e mësimdhënies fizike në klasë dhe me disa turne, kanëkrijuar vështirësi për mësuesit që të kujdesen për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve të tyre.

Ky manual përbën një udhëzues që synon t'i vijë në ndihmë përmirësimit të mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve, duke përdorur një model inovator, të quajtur modeli CIAO.

Mbrojtja e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve përbën një investim për periudhën e adoleshencës dhe për periudhat emëvonshme të jetës së tyre.

Ajo çka prezantohet këtu, është eksperimentuar në kuadër të nismës "Përdorimi i modelit 'CIAO' për të përmirësuar mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve", mbështetur nga Terre des Hommes Albania, Child Hub dhe zbatuar nga Shoqata për Trashëgimi dhe Edukim dhe Instituti "Master Thinker" përgjatë periudhës maj-tetor 2021.

Kujt i shërben ky manual?

Ky manual i dedikohet fëmijëve të grupmoshës nga 6 deri në 14 vjeç dhe synon të shërbejë si një instrument që ndihmon zbatimin e qasjes edukuese të "Zhvillimit të kompetencave kyçe për fëmijët", siç parashikohet në dokumentin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të vitit 2014, e quajtur "Korniza kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë".

Zbatimi i kësaj kornize kurrikulare, tashmë prej 6 vitesh, është përballur dhe përballet me sfida të natyrave të ndryshme, prandaj ky manual, nëpërmjet ushtrimeve praktike, synon që të jetë ndihmës për këdo që është i interesuar të ndihmojë fëmijët të zhvillojnë aftësitë e tyre për jetën.

Ky manual reflekton përvojën e suksesshme të nismës Përdorimi i modelit “CIAO” për të përmirësuar mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve” dhe synon t’u vijë në ndihmë:

- Mësuesve që punojnë me fëmijë të grupmoshës 6-14 vjeç;
- Prindërve të fëmijëve të kësaj grupmoshe;
- Organizatave që kanë në fokus mirëqenien e fëmijëve;
- Instutucioneve hartuese dhe zbatuese të politikave arsimore me qasje kurrikulare dhe ekstrakurrikulare.

Pjesa e Parë

Të Njohim Modelin Ciao

dhe Konceptin e Mirëqenien Socio-Emocionale

1.1 Ç'është modeli CIAO?

"CIAO" (Competencies Island Advancement Orientation) është emërtimi i procesit të Orinetimit të Zhvillimit të Ishullit të Kompetencave, i cili në këtë manual është fokusuar te fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç, duke u ndalur më ngushtësisht te nëngrupet: 6-10 vjeç dhe 10 -14 vjeç.

Po ç'është ishulli i kompetencave?

Ideja e "ishujve të kompetencës" u propozua fillimisht nga Robert B. Brooks, si një metaforë për t'u ardhur në ndihmëprindërve të fëmijëve të prekur nga ADHD (Attention Deficit Hyperactivity Disorder), ose siç njihet në shqip "Çrregullimi i Mungesës së Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit", **për të ndihmuarfëmijët e tyre të përballen me vështirësitë.**

"Të gjithë fëmijët kanë pikat e forta ose ishujt e tyre të kompetencës," - shkruan Dr. Brooks në "Nuturing Islands of Competence" (Të ushqesh ishujt e kompetencave). Sipas tij, të rriturit duhet të identifikojnë pikat e forta të secilit fëmijë dhe më pas të shpenzojnë kohë dhe energji për t'i zhvilluar dhe përdorur këto pika të forta për t'i ndihmuar fëmijët të kenë sukses. Zhvillimi i pikave të forta ka një ndikim më të fuqishëm dhe më afatgjatë te zhvillimi i fëmijëve, krahasuar me plotësimin e mangësive".[1]

[1]Shih:https://chadd.org/adhd-weekly/qa-what-are-islands-of-competence/#:~:text=Answer%3A%20The%20idea%20of%20islands,islands%20of%20competence%2C"%20Dr.

Kjo ide e Brooks, e zbatuar në një kontekst më të gjerë, nxjerr në pah se çdo fëmijë mund të zhvillojë kompetenca të tjera përmes ishujve të kompetencës personale, duke zhvilluar ato aftësi dhe tipare në të cilat ai është i suksesshëm, për shembull në aktivitetet shkollore dhe të jetës së përditshme si: arti, sporti, muzika ose pasione të tjera. Ndjenjat pozitive i ndihmojnë fëmijët të përqëndrohen më mirë në procesin e të mësuarit, në bashkëveprimin, krijimin dhe suksesin. Këto ndjenja pozitive forcojnë vetëvlerësimin e fëmijëve dhe nxisin tek ta optimizmin, lehtësimin, të qenurit të pavarur etj., të cilat janë shumë e rëndësishme për të qenë të suksesshëm në aktivitetet e jetës së përditshme.

Përmes zhvillimit të ishujve të kompetencës fëmijët pajisen me disa aftësi për sukses jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen. Aftësi të tilla si: të menduarit pozitiv, zgjidhja e problemeve, ndërtimi i marrëdhënieve, të dëgjuarit aktiv, empatia, komunikimi, prezantimi i vetvetes, etj., e pajisin fëmijën me kapacitete për të përballuar situata jetësore në një kuptim afatgjatë edhe si i rritur më vonë.

Duke iu referuar kësaj ideje të Dr. Brooks, u ndërtua modeli CIAO, i cili u zbatua në një mënyrë "eksperimentale" me 19 fëmijë të grupmoshës 6-14 vjeç, të ndarë në nëngrupet e sipërpërmendura, përvojë kjo që është shpjeguar më qartë në pjesën e tretë të këtij manuali.

1.2 Të njohim konceptin e mirëqenies socio-emocionale

Në jetën e përditshme, kur flasim për mirëqenien, sidomos në Shqipëri, ne mendojmë për mirëqenien ekonomike. Në të vërtetë koncepti i mirëqenies është shumë më i gjerë se kaq. Koncepti i mirënies është i lidhur ngushtë me emocionet pozitive, të tilla si: lumturia, gëzimi, kënaqësia, entuziazmi, qetësia etj. Ajo përfshin gjithashtu shëndetin e mirë fizik dhe lidhjet pozitive e kuptimplota shoqërore.

Mirëqenia socio-emocionale përbëhet nga dy pjesë, të lidhura shumë ngushtë me njëra-tjetrën: mirëqenia sociale dhe ajo emocionale.

Mirëqenia sociale

Mirëqenia sociale lidhet me krijimin, zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve kuptimplota me të tjerët. Kjo lejon të ndjerit unik dhe të vlerësuar, dhe ndihmon përmbushjen e nevojës së lidhjes dhe përkatësisë.

Për shembull, kur punoni në një skuadër për një periudhë prej disa muajsh ose vitesh, madje edhe në distancë, keni mundësinë t'i njihni më shumë anëtarët e skuadrës. Ju zhvilloni rutina ose shaka të brendshme. Pyesni njeri-tjetrin për interesat e përbashkëta ose të veçanta. Ndjeni mungesën e njeri-tjetrit. Disa prej jush bëhen miq me njeri-tjetrin dhe shkëmbejnë biseda në një nivel më të thelluar. Ka të ngjarë t'i shihni miqtë tuaj në ditë të këqija kur mund t'u ofroni ndihmë, ose në në ditë të tjera kur ata mund t'ju ofrojnë ndihmë. Të dyja këto lloj marrëdhëniesh i shërbejnë mirëqenies shoqërore, duke sjellë kënaqësi dhe duke lejuar të bëhesh i pranishëm dhe i pranueshëm për të tjetët, si dhe të çmohesh e vlerësohesh për atë që je.

Pse është e rëndësishme mirëqenia sociale?

Ne jemi krijesa shoqërore që kanë nevojë për njëri-tjetrin. Një pjesë e trurit tonë (sistemi limbik) është përgjegjëse për dëshirën tonë për të qenë me të tjerët, rreth të tjerëve dhe e lidhur me të tjerët. Ajo krijon brenda nesh ndjenja sigurie dhe lumturie kur jemi me «të ngjashmit» tanë.

Nëse mirëqenia jonë sociale nuk do të ishte e zhvilluar, ne do të rrezikonim të ishim të izoluar nga pikëpamja shoqërore. Te jesh i izoluar nga shoqëria, nuk është njëlloj si të zgjedhësh të jesh për ca kohë vetëm e të shijosh vetminë. Izolimi social nuk është një zgjedhje. Të tërhiqesh nga marrëdhëniet njerëzore kthehet në një spirale që të merr me vete (imagjinoni një gropë thithëse, ose një vorbull), sepse izolimi nxit lindjen e ndjenjave negative të frikës dhe të kërcënimit që nxisin akoma më shumë sjellje izoluese. Izolimi shoqëror nxit vetminë, e cila mund të jetë shkatërruese. Thuhet se vetmia mund të jetë po aq e dëmshme sa të pish 15 cigare në ditë.

Nëse e keni luajtur ndonjëherë video lojën "*The Sims",* do t'ju kujtohet se në panelin e "nevojave" tuaja, përfshihej një bar social, i cili zvogëlohej nëse ju nuk do të flisnit me askënd për një kohë të caktuar. Kjo, si të thuash na kujton se "Miqësitë janë si lulet, të cilat nëse nuk ujiten, vyshken". Lidhjet shoqërore janë, si të thuash, pjesë e pandashme e përvojës njerëzore, të cilat nuk lihen pa u marrë në konsideratë dhe nga prodhuesit e video lojërave në botën virtuale.

Mirëqenia emocionale

Mirëqenia emocionale lidhet me aftësinë për të shprehur në mënyrë të sigurtë ose për të menaxhuar emocionet, si dhe për të gjeneruar emocione pozitive. Ajo nis me të qenurit të ndërgjegjshëm se çfarë po ndjeni. Në të vërtetë shumë njerëz luftojnë me paditurinë emocionale dhe nuk kuptojnë se çfarë ata ndjejnë realisht ose e kanë të pamundur të përcaktojnë se çfarë ndjejnë dhe për rrjedhojë, janë të paaftë t'i

shpehin emocionet e tyre. Të shprehësh emocionet te të tjerët përbën një mënyrë për të përmirësuar mirëqenien emocionale si dhe jep një mundësi për t'i lejuar të tjerët të shprehin emocionet e tyre gjithashtu. Për ta bërë këtë, fjalia mund të nisë me shprehjen "Unë ndihem…", shprehje të cilën shumë pak nga ne e kanë bërë zakon ta përdorin.

Të gjesh kohë të merresh me veprimtari që gjenerojnë emocione pozitive është po aq e rëndësishmesa të menaxhosh edhe emocionet negative. Për shembull, studimet kanë treguar se fuqia e mirënjohjes gjeneron emocione pozitive.

Studiuesi Shawn Achor sugjeron të bëjmë një ushtrim të tillë: Çdo ditë të mendojmë për tre gjëra të vecanta, për të cilat të jemi mirënjohës. Ai propozon që çdo ditë ta ushtrojmë trurin që të mendojë për tre gjëra të reja dhe, nëse fokusohemi tek to dhe gjenerojmë mirënohje çdo ditë, mirëqenia jonë emocionale do të përmirësohet.

Mirëqenia emocionale lidhet ngushtë me mirëqenien sociale, sepse ne bëhemi të aftë të krijojmë dhe të ruajmë marrëdhënie të mira me të tjerët, kur ne jemi të aftë të menaxhojmë dhe rregullojmë emocionet tona. Nga ana tjetër, të qenurit i përfshirë në marrëdhënie shoqërore domethënëse dhe të qëndrueshme, ndihmon në të ndjerin mirë dhe përbën një instrument motivues shumë të mirë për të menaxhuar emocionet tona. Pra mirëqenia emocionale ndihmon mirëqenien sociale dhe anasjelltas, ajo sociale ndihmon atë emocionale.[2]

Vlera e përmirësimit të mirëqenies socio-emocionale

Studiuesit Lawrence dhe Wrong, duke iu referuar punës së shumë studiuesve të tjerë, paraqesin vlerat dhe dobinë që sjell përmirësimi i mirëqenies socio-emocionale te fëmijët. Kështu sipas studimeve:

---

2 https://www.betterup.com/blog/what-is-social-well-being-definition-types-and-how-to-achieve-it

- Fëmijët, të cilët janë kompetentë nga ana shoqërore dhe të zhvilluar mirë nga pikëpamja sociale-emocionale, do të kenë një shanc më të lartë për të qenë të suksesshëm edhe në në shkollë, për të gjetur punën e dëshiruar në të ardhmen dhe për të krijuar marrëdhënie të sigurta dhe të qëndrueshme shoqërore.

- Ata kanë më pak gjasa të përfshihen në aktivitete kriminale, më pak gjasa të përdorin dhe të abuzojnë me substanca narkotike dhe më pak shance të kenë probleme të shëndetit mendor.

- Është vërtetuar gjithashtu se mangësitë sociale dhe emocionale përbëjë pengesa kryesore të përshtatjes së fëmijëve në shkollë dhe gjenerojnë shumë probleme të sjelljes, siç janë sjelljet përçarëse, agresiviteti, sjelljet kundërshtuese dhe jo-pajtuese. Pra mirëqenia e mirë shoqëroredhe emocionale siguron një bazë për përshtatje të mirë në shkollë dhe, nga ana tjetër, rrit ndjenjën e përkatësisë. Kjo e fundit duket të jetë e lidhur me ndikimin pozitiv, vetë- efikasitetin dhe arritjet shkollore. Këto kanë forcuar argumentin për nevojën e programeve të ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme për të mbështetur rezultatet pozitive të të mësuarit më vonë në të gjitha fushat, duke mbajtur një fokus në promovimin e zhvillimit të shëndetshëm social-emocional.[3]

Në vitin 2013 studiuesi Eduardo Bericat publikoi një studim në lidhje me indeksin e mirëqenies socio-emocionale[4]. Duke iu referuar dy studiuesve të tjerë Thomas Kemper dhe Randall Collins, Berikat

---

[3] Shih: Lawrence T. Lam and Emmy M. Y. Wong (2017) Enhancing social-emotional well-being in young children through improving teachers' social-emotional competence and curriculum design in Hong Kong.
International Journal of Child care and education policy. https://ijccep.springeropen.com/track/pdf/10.1186/s40723-017-0031-0.pdf

[4] Shih: Bericat, E. (2013). The Socioemotional Well-Being Index (SEWBI): Theoretical Framework and Empirical Operationalisation. Social Indicators Research, 119(2), 599–626. doi:10.1007/s11205-013-0528-z

ndërtoi një instrument për të matur mirëqenien socio-emicionale te të rriturit në fakt, por që përbën një model shumë interesant për t'u përdorur edhe për fëmijët.

Më poshtë, në mënyrë të thjeshtuar është paraqitur ky instrumet i quajtur SEWBI që vjen nga anglishtja e do të thotë: Socio-Emotional Well Being Index (Indeksi i Mirëqenies Socio-Emocionale). Kështunë shqip le ta quajmë IMSE.



Figura nr. 1: IMSE: treguesi, nëntreguesit dhe gjendjet emocionale

Autor: Bericat, E., 2013: 620

Bazuar në këtë indeks, ky autor ka ndërtuar edhe një pyetësor për të mundësuar matjen e mirëqenies socio-emocionale (Shih shtojcën nr. 1).

1. Kompetencat kyçe dhe rëndësia e zhvillimit të tyre

Në vitin 2014, arsimi parauniversitar u prek nga një reformë e rëndësishme, e cila u bazua në një filozofi të re mësimdhënieje, e cila synoi të nxiste lidhjen midis të nxënit në shkollë dhe jetës së vërtetë. Ministria e Arsimit dhe e Sporteve në atë kohë, hartoi një dokument shumë të rëndësishëm të njohur si "Korniza kurrikulare për arsimin parauniversitar, 2014"[5]. Në këtë dokument, reflektohen përvoja të suksesshme ndërkombëtare që synojnë aftësimin e fëmijëve për jetën dhe jo thjeshtë të mësuarin mekanik që shkollat diktonin më parë.

Ndryshimet e rëndësishme dhe shumë të shpejta shoqërore, diktojnë domosdoshmërinë e përshtatjes së sistemit arsimor me kapacitetet të reja, për t'iu përgjigjur sa më mirë ndryshimeve jashtë saj, e për ta bërë shkollën sa më të integruar me shoqërinë.

Kështu, në dokumentin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në vitin 2014., janë përcaktuar 7 kompetenca kyçe, të cilat i ndihmojnë fëmijët që të përshtaten me botën e sotme në ndryshim. Ato janë si më poshtë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
- Kompetenca e të menduarit;
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
- Kompetenca personale;
- Kompetenca qytetare;
- Kompetenca digjitale;

[5]https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf

Në tabelën e mëposhtme këto kompetenca janë zbërthyer në nënkompetenca, duke iu referuar dokumentit të MAS 2014.

KOMPETENCAT KYÇE	
1.	**Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**
	Nxënësi komunikon në mënyrë efektive.
	o Komunikon në gjuhën amtare. o Komunikon në gjuhë të huaja. o Shprehet me anë të simboleve, kodeve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. o Komunikon nëpërmjet teknologjive të informacionit. o Përkushtohet dhe kontribuon për dialog konstruktiv. o Respekton rregullat e komunikimit. o Shpreh tolerancë dhe empati në komunikim. o Komunikon në mënyrë konstruktive.
2.	**Kompetenca e të menduarit**
	Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.
	o Analizon, sintetizon,gjykon, vlerëson, interpreton, krijon dhe mbron qëndrimin e tij të pavarur, etj. o Merr vendime në bazë të informacioneve të plota e të verifikuara. o Lidh vendimet me pasojat. o Vlerëson dhe vetëvlerësohet.

	○ Zgjidh probleme. ○ Zotëron kompetencat në fushat kryesore të dijes (matematikë, shkenca natyrore e shoqërore,teknologji, etj.).
3.	**Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**
	Nxënësi mëson për të nxënë.
	○ Identifikon dhe shfrytëzon strategji dhe teknika të të nxënit. ○ Zotëron si duhet leximin,shkrimin,matematikën,shkencën dheTIK-un. ○ Identifikon dhe përpunon informacione në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. ○ Mëson dhe shkëmben përvoja pozitive në grup.
4.	**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**
	Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.
	○ Paraqet mirë vetveten,duke vënë theksin në pikat e forta. ○ Punon në mënyrë të pavarur dhe në grup. ○ Organizon dhe udhëheq veprimtari të të nxënit dhe shoqërore. ○ Demostron shkathtësi sipërmarrëse, njohuri për planifikimin e punës dhe përshfrytëzimin racional të kohës. ○ Zotëron aftësi për menaxhimin e konflikteve dhe vlerësimin e rreziqeve.

	○ Ndërmerr veprime të pavarura dhe të përgjegjshme. ○ Merr pjesë në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.
5.	**Kompetenca personale**
	Nxënësi bën jetë të shëndetshme.
	○ Shfaq vetëbesim. ○ Menaxhon emocionet dhe stresin. ○ Ndihmon dhe shfaq empati për të tjerët. ○ Demonstron aftësi për të bërë jetë të shëndetshme. ○ Bën zgjedhje të përgjegjshme për shëndetin vetjak.
6.	**Kompetenca qytetare**
	Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.
	○ Ndërton marrëdhënie me të tjerët, me shoqërinë dhe me kulturat e tjera. ○ Mirëkupton dhe respekton dallimet ndërmjet njerëzve. ○ Pranon dhe respekton të tjerët. ○ Demonstron përgjegjësi për çështje të interesit të përgjithshëm publik. ○ Merr pjesë në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në çështje të interesit publik. ○ Përkrah dhe nxit ndryshime të dobishme për jetën vetjake, për shoqërinë dhe për mjedisin.

7.	**Kompetenca digjitale**
	Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin
	○ Përdor disa aplikacione si: word, spreadsheets, databaza etj. ○ Mbledh dhe përpunon informacionin që gjendet nga interneti apo komunikimi elektronik. ○ Vlerëson rreziqet që vijnë nga interneti apo komunikimi elektronik. ○ Gjykon për vërtetësinë e informacionit dhe për parimet etike dhe ligjore në përdorimin interaktiv të TIK-ut. ○ Përdor TIK-un për të zhvilluar mendimin kritik dhe krijues. ○ Identifikon, analizon dhe përdor sistemet aplikative për zgjidhjen e problemeve.

Modeli CIAO, kompetencat kyçe dhe mirëqenia socio-emocionale e fëmjëve

Sikurse u paraqit edhe më sipër, modeli CIAO fokusohet në zhvillimin e ishujve të kompetencave të fëmijëve. Çdo fëmijë është unik dhe ishujt e tij të kompetencave mund të jenë të lidhur me një ose disa prej kompetencave të paraqitura në kornizën kurrikulare të MAS, kornizë e cila orienton procesin arsimor, por që në mënyrë krejttë natyrëshme mund të përvetësohet edhe nëpërmjet veprimtarive ekstrakurrikulare.

Përvoja ka treguar që ka një prirje që mësuesit dhe prindërit, pra të atyre që merren me edukimin dhe rritjen e fëmijëve, të dëshirojnë dhe

të presin që fëmijët të shkëlqejnë kudo, dhe të jenë të pajisur me të gjitha kompetencat në mënyrë të përsosur. Shprehje të tilla si “ai është i gjithashëm ose ajo është e gjithanshme”, “është me të gjitha 10-ta”, “nxënës ekselent kudo” etj., vënë në pah që shpesh tek prindërit dhe mësuesit mungon fokusi për të identifikuar “ishulljt e kompetencave” tek fëmijët, atë çka e bën atë unik, krahasuar me të tjerët, atë që e bën atë të dallueshëm e më të cilin ai fëmijë mund të shquhet. Vendosja e standardeve të përbashkëta për fëmijët synon t’i uniformizojë fëmijët e t’i bëjë ata të humbasin të veçantën e tyre. Modeli CIAO, në të kundërt mbështetet në idenë që, më tepër se zhvillimi në mënyrë homogjene i të gjitha kompetencave te të gjithë fëmijët, duhet ndjekur rruga e përforcimit të ishujve të kompetencave tek secili prej tyre. Kjo rrugë më pas, në mënyrë krejt të natyrshme do të ndikojë në përmirësimin e aftësive të tjera tek nxënësit.

E keni parë filmin “Shoku ynë Tili”? Ai është një film i realizuar në vitin 1981 dhe paraqet një realitet shoqëror disi ndryshe nga ky i sotmi, por aty tregohet shumë qartë se si përmirësimi i mirëqenies socio-emocionale të Nertilit, si dhe përpjekjet e vazhdueshme të disa mësueve për të zhviluar ishujt e tij të kompetencave, ndikoi në suksesin e tij shkollor dhe në zhvillimin e kompetencave të tjera si: kompetenca e të mësuarit për të nxënë, kompetenca qytetare, personale, etj.

Pak a shumë kjo është edhe filozofia që modeli CIAO kërkon të vërë në zbatim.

Më poshtë paraqitet një rubrikë me ushtrime që mund t’u vijë në ndihmë mësuesve dhe profesionistëve të tjerë të edukimit për të punuar me zhvillimin e ishujve të kompetencave te fëmijët.

Pjesa II

Ushtrime Praktike

Si mund të ndikojë Modeli Ciao në Mirëqenien Socio-Emocionale? Puna me fëmijët

2.1 Ushtrime Praktike: Kompetenca Komunikimit dhe të Shprehurit

a. Ç'është kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit?

Kompetenca e komunikimit përfshin tërësinë e aftësive, të cilat i përdorin nxënësit për të transmetuar dhe shkëmbyer informacion, përvoja dhe ide, dhe për të eksploruar botën përreth tyre. Kompetenca e komunikimit zhvillon disa aftësi si: të shpehurit qartë, të shprehurit i ideve dhe mendimeve në mënyrë të organizuar, të bërit dialog, dëgjimi aktiv, shprehja e emocioneve, etj.

b. Si mund të ndikojë kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve?

Ndikimi i kompetencës së komunikimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me zhvillimin e marrëdhënieve me të tjerët. Zhvillimi psiko- emocional është i lidhur me zhvillimin e aftësive sociale te fëmijët. Disa fëmijë miqësohen dhe bëjnë shoqëri shpejt, ndërsa disa të tjerë janë më të vetmuar. Vihet re se përmes komunikimit fëmijët mësojnë sjellje sociale. Marrëdhëniet me të tjerët janë shumë të rëndësishme për fëmijët, përmes tyre fëmijët përmirësojnë vetëkontrollin, imazhin për veten dhe përballojnë me sukses vështirësitë në jetën e përditshme. Përmes komunikimit dhe të shprehurit dhe bisedave me njëri-tjetrin, fëmijët zhvillojnë të kuptuarit dhe mësojnë perspektiva tëndryshme si dhe mësojnë konsensusin.

c. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Interesat e mia

Përmes kësaj veprimtarie fëmijët mësojnë të bëjnë dialog, tëdëgjojnë në mënyrë aktive njëri-tjetrin si dhe të eksplorojnë interesat e përbashkëta si një mundësi për të nxitur shoqërinë me njëri-tjetrin.

Hapi i parë: Fëmijët ndahen në grupe dyshe për të biseduar me njëri-tjetrin rreth dëshirave dhe interesave të tyre.

Hapi i dytë: Fëmijët shprehen duke prezantuar dëshirat dhe interesat e njëri-tjetrit (shokut/shoqes në dyshe)

Hapi i tretë: Fëmijët diskutojmë së bashku me fëmijët e tjerë për interesat dhe dëshirat e përbashkëta dhe evidentojnë shokët / shoqet e ngjashëm.

Shembulli 2: "Lexo fytyrën time"

T'i mësojmë fëmijëve shprehjen e emocioneve përmes shprehive të ndryshme të fytyrës.Komunikimi jo verbal është po kaq i rëndësishëm sa komunikimi verbal. Fytyra shprehet njëlloj si fjalët. Kjo teknikë nxit përqëndrimin dhe interesin për tjetrin që kemi përballë, dhe i nxit ata në shprehjen e emocioneve.

Hapi i parë: Fëmijët vendosen përballë njëri–tjetrit, duke komunikuar në mënyrë joverbale lloje të ndryshme emocionesh që i udhëzon përmes fytyrës trajnuesi, duke komentuar leximin e emocioneve përmes fytyrës.

Hapi i dytë: Ata shprehin me radhë në çifte emocione të ndryshme përmes fytyrës, nën komandën "emocion trego" dhe shoku / shoqja gjen emocionin duke u fokusuar vetëm tek leximi i fytyrës.

Hapi i tretë: Të sjellim shembuj nga jeta e përditshme si i shprehin njerëzit emocionet përmes komunikimit verbal dhe joverbal.

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 10-14 vjeç

Shembulli 1:Të shprehemi dhe të dëgjojmë në mënyrë aktive "Kontakti me sy"

Kontakti me sy është një nga treguesit më të rëndësishëm në komunikim dhe dëgjimin aktiv. Fëmijët aftësohen të dëgjojnë në mënyrë aktive, duke u shprehur rreth një situate, duke mbajtur kontaktin me sy, si dhe mësojnë të mbështesin dhe të inkurajojnë personin që flet duke mbajtur kontaktin me sy. Kjo veprimtari nxit komunikimin emocional.

Hapi i parë: Fëmijët vendosen përballë njëri-tjetrit nëçifte dhe tregojne situata nga jeta e përditshme,duke ruajtur kontaktin me sy.

Hapi i dytë: Secili tregon edhe njëherë situatën përballë grupit, duke mbajtur kontaktin me sy me të gjithë anetarët e grupit.

Shembulli 2: Veprimtaria "Shkathtësitë leksikore"

Për të nxitur më tej të shprehurit dhe shkathësitë në të folur, si dhe për të identifikuar ata fëmijë që e kanë këtë ishull kompetence të zhvilluar, mund të përdoret loja e shkathësisë për t'u shprehur rrethnjë fushe të caktuar, duke u shprehur qartë dhe në mënyrë të organizuar.

Hapi i parë: Qëndrojmë në këmbë dhe krijojmë një rreth me grupin e fëmijëve.

Hapi i dytë: Caktojmë një fushë të caktuar për shembull "matematika". Pasojmë tek njëri-tjetri një top, duke thënë një fjalë / koncept që lidhet me fushën "matematika".

Hapi i tretë: Fëmijët që nuk janë të vemendshëm ose përsërisin atë çfarë ka thënë një fëmijë tjetër, duhet t'u përgjigjen disa pyetjeve, si një mënyrë ndëshkimi pozitiv.

2.2 Ushtrime Praktike: Kompetenca e të Menduarit

a. Ç'është kompetenca e të menduarit?

Kompetenca e të menduarit është shumë e rëndësishme për zhvillimin e mendimit kritik, kreativitetit dhe zgjidhjessë problemeve. Mendimi kritik zhvillon aftësitë e të menduarit në mënyrë të pavarur, për të prodhuar ide të reja dhe origjinale si dhe për tëzgjidhur probleme. Gjithashtu kjo competence nxit reflektimin kritik për përvojat dhe marrjen e vendimeve efektive si për shembull: shqyrtimi vetëm nga një këndvështrim i një çështjeje, vënia në dyshim e atyre dëshmive që nuk janë në pajtim me idetë tuaja, arsyetimin e bazuar në pasion e jo në logjikë, mosmbështetja e deklaratave me dëshmi etj.

b. Si mund të ndikojë kompetenca e të menduarit në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve?

Kur fëmijët ndeshen me një problem dhe nuk kanë burime për ta zgjidhur ata ndihen të paaftë dhe jo kompetentë. Përmes fuqizimit të mendimit kritik fëmijët mësojnë në mënyrë të pavarur për të zgjidhur probleme të zakonshme me metoda të zakonshme dhe probleme të jashtëzakonshme me metoda të reja duke nxitur kreativitetin. Të menduarit nxit reflektimin mbi situatat reale dhe gjendjen emocionale duke rritur aftësitë, vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e tyre.

c. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Rubrika bëj një pyetje edhe një pyetje tjetër

Fëmijët që pyesin duan të hulumtojnë dhe të njohin botën që i rrethon. Sa më shumë pyetje aq më shumë të panjohura për t'u zbuluar. Qëllimi është që fëmijët të bëjnë sa më shumë pyetje, duke menduar për pyetje më të thella. Kjo teknikë nxit shpehitë e të menduarit.

Fëmijët propozojnë emra dhe koncepte të ndryshme për të bërë pyetje. Psh: zgjedhim fjalen "uji" ose "dielli" ose "lule" dhe fëmijët bëjnë sa më shumë pyetje rreth tyre. Shkruajmë të gjitha pyetjet në flipchart për të nxitur pyetje të tjera. Me pas fëmijët përpiqen t'u pergjigjen disave prej pyetjeve.

Shembulli 2: Lojëra logjike "Mendo, mendo, mendo"

Femijëve i shfaqim në ekran disa pyetje dhe situata logjike.

1. Unë nuk jam e gjallë, por kam 5 gishterinj (dorashka);
2. Kur më ushqen, më jep jetë, kur më jep për të pirë, unë vdes (zjarri);
3. Dy njerëz kanë lindur në të njëjtin moment, por nuk kanë të njëjtën ditëlindje (kanë lindur në dy vende që kanë orë të ndryshme);
4. Imagjinoni sikur jeni në një varkë dhe jeni të rrethuar nga disa peshkaqenë. Si mund të shpëtoni nga kjo? (Mos imagjinoni)

5. Një majmun, një ketër dhe zog po ngjiten mbinjë pemë arrekokosi. Cili ngatë tre do kapë bananen i pari? (asnjeri).

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Zgjidh problemin

Secili femijë duhet të përpiqet të zgjidhë një nga problemet e mëposhtme individualisht:

1. Hana, Kristel dhe Enes duan të ulen tek e njejta karrige.
2. Orioni ka harruar të sjellë projektin në shkollë.
3. Ana i thote Sarës "Ti je e shëmtuar". Çfarë duhet të bëjë ajo?
4. Najeli nuk mori një ftesë nga shoqja e saj për ditëlindje. Çfarë duhet të bëjë ajo?
5. Lura shkon në një shkollë të re. Çfarë duhet të bëjë ajo që të bëjë shokë dhe shoqe?

Shembulli 2: Zgjidhje problemesh në grup

Kjo veprimtari nxit bashkëpunimin, komunikimin dhe aftësinë për të menduar në grup. Krijojmë grupe me fëmijë dhe japim disa situate, të cilat duhet të zgjidhen në grup. Zgjidhja e problemeve bëhet më e lehtë kur fëmijët mësojnë disa strategji të menduari për zgjidhje problemesh.

Grupet duhet të zgjidhin situatat e mëposhtme:

1. Zgjidhni një vend ku ju së bashku do të bënit një eskursion.
2. Duhet të zgjedhim një dhuratë për Etjenin, 14 vjeç.

3. Nuk ka karrige mjaftueshëm për t'u ulur të gjithë.
4. Jeni 8 veta, por ka vetëm 5 copa keku.
5. Dy grupe duan të luajnë basketboll, por ka vetëm një top.

2.3 Ushtrime Praktike: Kompetenca e të Mësuarit për të Nxënë

a. Ç'është kompetenca e të mësuarit për të nxënë?

Kompetenca e të nxënit i aftëson fëmijët për të mësuar perms teknika vetë tënxënit dhe për të lehtësuar këtë proces. Fëmijët mësojnë të jenë të sukseshëm në të nxënë, shkrim, lexim, matematikë, logjikë etj. Gjithashtu përmes kësaj kompetence, ata mësojnë të analizojnë dhe të përpunojnë informacionin në mënyrë efektive dhe të pavarur. Kjo kompetencë i nxit për të qenë të përgjegjshëm dhe sukseshëm.

b. Si mund të ndikojë kompetenca e të mësuarit për të nxënë në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve?

Fëmijët që zotërojnë një kompetencë të tillë, përgjithësisht janë të pavarur për të krijuar njohje të reja dhe ndjenja e pavarësisë i bën ata të ndihen mirë në grup e në situata të panjohura, ku ata mund të përshtaten me lehtësi. Përmes të nxënit dhe njohurive ata krijojnë bazën për të arsyetuar dhe për të përcjellë informacionin eduhur. Kjo kompetencë rrit vetëbesimin dhe vetëvlerësimin, duke rritur perceptimin pozitiv per veten. Kjo kompetencë i bën fëmijët kompetentë në disa fusha.

c. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Pyetje dhe kuriozitete për botën e kafshëve

Hapi i parë: Bëjmë disa pyetje për të nxitur kuriozitetin.

- Cila është kafsha më e shpejtë: (gepardi, japim informacionin e plotë)
- Vrasësi më i madh: (mushkonja anofele, japim informacionin e plotë)
- Më jetëgjata: (balena kokëçekiç, japim informacionin e plotë)
- Më i fuqishmi: (brumbulli rineceront: japim informacionin e plotë)

Hapi i dytë: Mësojmë disa teknika të thjeshta.

- Teknika1: për të mësuar sa më shpejt informacionin e ri për kafshët.
- Teknika 2: për të mbajtur mend më shumë.
- Teknika 3: për të folur qartë.
- Teknika 4: për të folur rrjedhshëm.

Shembulli 2: Më gjej emrin

Japim informacionin e plotë për lloje të ndryshme nga bota shtazore dhe fëmijët duhet të gjejnë cilët janë ata:

1. Kanë gjak të ngrohtë, flatra dhe sqep etj. (Shpendët). Listoni disa prej tyre.

2. Ushqehen me qumësht nga nënat e tyre, shumica kanë trup të mbuluar me qime. (gjitarët) Listoni disa prej tyre.
3. Jetojnë edhe në tokë edhe në ujë (amfibët). Listoni disa prej tyre.

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 10-14 vjeç

Shembulli 1: Teknika për rrjedhmëri në të folur

Persërisni sa më shpejt dhe rrjedhshëm:

- "Plepi plak i plasur pak place paska pasur"
- "Një thes shitës që shet thasë në shesh, rri dhe thasë shet. Shitmë dhe mua një thes nga ato thasët që ti shet"

Shembulli 2:Shfaqje e një sekuece filmike

Përmes një sekunce filmike nga filmi "Shoku ynë Tili", fëmijët disktojnë për aftësitë që kanë të gjithë fëmijët për të nxënë dhe se si ata mund të kapërcejnë çdo vështirësi, përmes ndihmës që i ofrojnë mësuesit apo prindërit e tyre.

Fëmijët ndahen në dy grupe dhe diskutojnë:

Grupi i parë: Aftësitë dhe kompetencat. Sa na kuptojnë prindërit?

Grupi i dytë: Aftësitë dhe kompetencat. Sa na kuptojnë mësuesit?

Diskutimet e tyre i kemi përmbledhur në dy podcast-e.

Poadcast I

Poadcast II

2.4 Ushtrime Praktike: Kompetenca për Jetën, Sipërmarrjen dhe Mjedisin

a. Ç'është kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin?

Kjo competence mundëson që fëmijët të jenë të sukseshëm në jetën e tyre, duke vënë theksin tek aftësitë dhe potenciali që kanë dhe për t'i nxitur më tej për të ushtruar veprimtari që i ndihmojnë për të nxënë, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe grup. Kjo competence ndihmon fëmijët për veprimtari sipërmarrëse si dhe për t'u kujdesur për mjedisin.

b. Si mund të ndikojë kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin në përmirësimin e mirëqenies socio- emocionale të fëmijëve?

Kjo kompetencëi ndihmon fëmijët të bëjnë ndryshime pozitive tek vetja duke ndërvepruar me të tjerët në një mjedis pozitiv dhe tëpranueshëm. Duke identifikuar probleme dhe duke menduar strategji për zgjidhjen e tyre, ata identifikojnë situatat ku duhen t'i marrin vetë vendimet dhe kur duhet të bashkëpunojnë me të tjerët. Duke respektuar diversitetin dhe duke pranuar dallimin me të tjerët, fëmijët ndihet të pranuar në një mjedis pozitiv.

c. lustrime dhe ushtrimepër fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Të zhvilljmë kompetencat nëpërmjet aktrimit

Fëmijët marrin përsipër të interpretojnë një pjesë teatrore me subjekt "Natyra", ku të theksojnë rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës nga njeriu.

Hapi i parë: Secili fëmijë zgjedh një personazh të caktuar (lule,peme, kafshë, diell, ujë, natyrë, shi, njeri, etj.)

Hapi i dytë: Përmes empatisë secili përshkruan si ndihet kur jeta e secilit është në rrezik.

Hapi i tretë: Secili personazh do të tregojë pse ka rëndësi mbrojtja e mjedisit për të.

Foto 8, 9, 10, 11: Momente nga CIAO show

Shembulli 2: Të integrojmë aftësitë dhe njohuritë tona për natyrën

Fëmijët ftohen të komunikojnë me natyrën në mënyra të ndryshme.

-Dikush sjell vazo e dhe dhe mbjell një lule;

-Dikush bën një poezi ose ese për natyrën;

-Dikush zgjedh të këndojë një këngë përnatyrën, ose t'i bjerë një vegleje muzikore me një melodi që lidhet me natyrën;

-Dikush merr përsipër të vizatojë natyrën ose të bëjë një pankartë me mesazh ndërgjegjësuespër dëmet që njeriu i shkakton natyrës;

-Dikush mund të përgatisë me anë tëkompjuterit një mesazh të tillë ndërgjegjësues për ta shpërndarë në rrjetet sociale.

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 10-14 vjeç

Shembulli 1: Kreativiteti dhe sipërmarrja

Fëmijët i ndajmë në tre grupe:

1. Grupi 1. Çfarë do të ndryshonit tek një biçikletë për të krijuar një model më inovator?
2. Grupi 2. Çfarë do të ndryshonit tek një krevat për ta bërë më inovator?
3. Grupi 3. Çfarë do të ndryshonit tek një palë atlete për t'i bërë më inovatore?

Ne mund të jemi sipërmarrës të sukseshëm nëse:

- Jemi kreativë
- Jemi të përkushtuar
- Jemi kuriozë
- Jemi optimistë

Shembulli 2:**Veprimtari në natyrë**

Fëmijët zgjdhin të marrin përsipër një veprimtari në shërbim të natyrës.

Për shembull:

-Pastrojnë një zonë në plazh, pranë një lumi, apo një zonë urbane që nuk ka kujdesin e duhur nga njeriu.

- Zgjedhin mënyrën se si të rrisin ndërgjegjësimin edhe të të tjerëve për t'u kujdesur për natyrën.

-Ftohen tëjapin ide se si tëgjenerojnë disa të ardhura për të blerë për shembull: disa kosha për t'i vendosur në atë zonë, ose për të blerë ndonjë fidan, etj.

2.5 Ushtrime Praktike: Kompetenca Personale

a. Ç'është kompetenca personale?

Kompetenca personale rrit aftësitë e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit të fëmijëve. Kjo kompentencë nxit vetëdijen emocionale, vëtë-besimin, vetëvlerësimin, kujdesin për veten, respektin për veten dhe i ndihmon fëmijët të zhvillojnë empatinë.

b. Si mund të ndikojë kompetenca personale në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve?

Të qenit i vetëdijshëm për aftësitë dëshirat dhe idetë e tua është shumë e rëndësishme për fëmijët. Përmes kësaj kompetence fëmijët shprehin të gjithë potencialin personal, shprehin veten, emocionet dhendjenjat e tyre. Përmes kësaj kompetence fëmijët do të mësojnë të identifikojnë ndjenjat dhe emocionet e tyre, të shprehin ndjenjat e tyresi dhe të zbulojnë ishujt e kompetencave që i bëjnë ata të ndihen mirë me veten të rrisin vetëvlerësimin dhe vetëbesimin.

c. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Skica e vetes

Secili fëmijë plotëson një fletë që përban disa pyetje të thjeshta për të shprehur veten që lidhen me dëshirat emocionet dhe ndjenjat. Disa prejt tyre vihet re se kanë dëshirë të shprehen për veten dhe disa të tjerë shmangen. Qëllimi i kësaj veprimtarie është ata të shprehen sipas dëshirës dhe të identifikohen fëmijët që kanë vështirësi në shprehjen e emocioneve dhe ndjenjave të tyre. Skica e vetes kërkon të plotësohen vizat, sipas shembujve të mëposhtëm:

Kur jam e inatosur unë _____.

Kur dikush më bezdis unë_____.

Unë nuk ndihem mirë kur shokët ose shoqet_____.

Kur unë nuk bie dakort me shokun ose shoqen_____.

Une kërkoj falje kur_____.

Shembulli 2: Të identifikojmë ndjenjat

Hapi i parë: Shkruajmë në tabelë 4 grupe ndjenjash: i trishtuar, i zemëruar, i lumtur. i frikësuar.

Hapi i dytë: Pyesim fëmijët se cilat janë disa nga ndjenjat që ata përjetojnë gjatë një dite të zakonshme duke i shpjeguar se disa përjetojnë ndjenja mërzitjeje, disa janë të trishtuar, disa të lumtur, disa të frikësuar.

Hapi i tretë: Fëmijët tregojnë se çfarë bëjnë ata kur përjetojnë këto ndjenja?

Hapi i tretë: Diskutojmë rreth rëndësisë së këtyre ndjenjave dhe mënyrave të mira për t'i shprehur ato tek të tjerët.

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 10-14 vjeç

Shembulli 1: Veprimtaria "Ylli i Vetëvlerësimit"

Përmes kësaj veprimtarie fëmijët e kësaj moshe përfshihen në tematika që u pëlqejnë atyre duke ndarë idetë, aftësitë dhe arritjet e tyre. (Shiko shtojcën 2).

Secili prezanton dhe shpreh për veten, nëpërmjet shprehjes së:

a. Cilësive personale;
b. Cilësive dhe aftësive që i përcjellin në familje;
c. Cilësive dhe aftësive që i përcjellin në shoqëri;
d. Çfarë kanë arritur deri tani;
e. Gjërave që ata dinë të bëjnë shumë mirë.

Shembulli 2: Empatia

Hapi i parë: Në fillim pyesim grupin çfarë do të thotë të vendosësh veten në vendin e tjetrit dhe i inkurajojmë ata të ndajnë përvojat e tyre.

Hapi i dytë: Shpjegojmë çfarë është *empatia,* si një aftësi për të kuptuar ndjenjat e tjerëve sikur të ishin tonat dhe se kur ne kuptojmë dhe ndjejmë si të tjerët ne mund të krijojmë marrëdhënie më të mira me ta.

Hapi i tretë: Diskutimi mbi fleten e situatave për tëshprehur empatinë, lidhur me situatat, në të cilat ndodhen personazhet e marrë si shembuj.

Situata e parë: Kejtlin ka humbur rrugën. Si ndihet ajo?
Situata e dytë: Ema nuk doli shumë mirë në provim. Si ndihet ajo?
Situata e trete: Livia kam humbur çelësin e shtëpisë. Si ndihet ajo?

2.6 Ushtrime Praktike: Kompetenca Qytetare

a. Ç'është kompetenca qytetare?

Kompetenca qytetare kontribuon për komunitetin dhe shoqërinë, duke i bërë fëmijët pjesë shumë e rëndësishme tëshoqërisë, grupeve sociale dhe komunitetit. Fëmijët shpalosin vlerat e tyre të bashkëpunimit dhe përgjegjësisë sociale dhe aftësohen në zgjidhjen e problemeve në mënyrë paqësore.

b. Si mund të ndikojë kompetenca qytetare në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve?

Bashkëpunimi me të tjerët është një nga treguesit e kompetencës qytetare. Në një mjedis të sigurtë dhe ku ata mbështesin njëri tjetrin, ata ndihen pjesë e rëndësishme e grupit. Duke shfaqur respekt për të tjerët, duke përkrahur të tjerët, përmes kësaj kompetence fëmijët bëhen mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe respektojnë diversitetin, duke u bërë pjesë e rëndësishme e komunitetit ku ata bëjnë pjesë. Zhvillimi psiko-emocional mbështetet në dy tregues: ndërtimi i marrëdhënieve dhe mbështeja emocionale dhe sociale. Me pak mbështetje, fëmijët bëhen pjesë e grupit dhe mësojnë të ndërveprojnë me të tjerët.

c. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Lojë për bashkëpunimin" ishulli dhe peshkaqeni"

Përrmes lojës ishulli dhe peshkaqeni fëmijët nxiten për të qenë sa më shumë bashkëpunues dhe social me njëri-tjetrin.

Hapi i parë: Vizatojmë në tokë me shkumës një ishull.

Hapi i dytë: Një grup prej 8-10 fëmijësh vendosen të qëndrojnë në ishull. Ata imagjinojnë që në ishullin e tyre janë shumë të sigurtë, por në oqeanin përreth ka peshkaqenë. Fëmijët duhettë ndjekin dy komanda: a) iku peshkaqeni dhe mund të dalin lirisht në oqean dhe b) erdhi peshkaqeni dhe duhet të qëndrojnë në ishull. Fëmijët nuk duhet të prekin vijën e vizatuar.

Hapi i tretë: Për të nxitur bashkëpunimin mes fëmijëve, zvogëlojmë ishullin, duke e vështirësuar qëndrimin e fëmijëve. Nëse ata nuk e mbajnë njëri tjetrin, qëndrimi brenda vijës së ishullit do te jetë i vështirë.

Shembulli 2: Respekti dhe varësia nga të tjerët

Secili nga fëmijët plotëson në mënyrë të pavarur në një fletë sesi të tjerët i ndihmojnë ata për të arritur disa qëllime si psh:

-të bëhen më të mirë në sport;

-të mësojnë një vegël muzikore;

- të bëjnë detyrat etj.;

Përmes këtyre veprimtarive ata mësojnë të respektojnë, të ndihmojnë dhe të kuptojnë se njerëzit janë gjithmonë në marrëdhënie të tilla.

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 10-14 vjeç

Shembulli 1: Bashkëpunimi për të arritur një qëllim

Kjo veprimtari nxit bashkëveprimin me të tjerët, duke i bërë fëmijët më socialë e duke treguar interes për të tjerët, duke i shpjeguar se kur ata bashkëpunojnë mund të arrijnë më lehtë një qëllim, si psh. realizimi i një projekti në shkollë apo të bërit e një loje argëtuese.

Paraqiten disa situata ndërvepruese dhe shtrohen pyetje sipas secilës situatë. Për shembull: Cilat janë disa nga mënyrat e bashkëpunimit në familje, shoqeri, shkollë, etj.?

Shembulli 2: Të pranosh diferencën. Fleta "Vlerat e mia"

Fëmijët shprehin cilat janë vlerat e rëndësishme në jetën e tyre. Fillimisht secili në mënyrë individuale plotëson fletën "Vlerat e mia" e më pas i ndan idetë rreth vlerave personale me të tjerët, dukeshprehur dhe ndjenjat personale. Përmes vlerave ata flasin për mënyrën se çfarë është e rëndësishme në jetën e tyre dhe shprehin ide se çfarë duhet të bëjnë ata për t'i mbrojtur këto vlera dhe si ndihen atakur vlerat etyre janë në rrezik. Përmes kësaj veprimtarie fëmijët mësojnë gjithashtu të njohin këndvështrime të ndryshme dhe të mos bien domosdoshmërisht dakord, por duke respektuar njëri-tjetrin. (Shtojca 3)

Vlerat e mia

- Të merrem me sport
- Të krijoj
- Të bëj lojra logjike
- Të dal në natyrë
- Të luaj në instrument muzikor
- Të gatuaj
- Të udhëtoj
- Tjetër

2.7 Ushtrime Praktike: Kompetenca Digjitale

a. Ç'është kompetenca digjitale?

Kjo kompetencë aftëson fëmijët për të përdorur aftësinë dhe për të qenë të suksesshëm. Fëmijët demostrojnë aftësi në përdorim e aplikacioneve dhe të eksplojnë në internet për të gjetur informacione eburime të sakta të dhënash si dhe të komunikojnë në mënyrë virtuale. Fëmijët aftësohen ta përdorin në mënyrë efektive dhe të dobishme teknologjinë për të zhvilluar mendimin kritik dhe krijues dhe duke përdorur sistemet aplikative për zgjidhjen e problemeve.

b. Si mund të ndikojë kompetenca digjitale në përmirësimin e mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve?

Fëmijët janë shumë të aftë në përdorimin e teknologjisë. Kjo i ndihmon ata të jenë të aftë dhe konkurues në një mjedis ku teknologjia ka gjetur gjithnjë e më shumë hapësirë. Duke demonstruarnjohuritë e tyre në përdorimin e aplikacioneve të ndryshme, fëmijët përmirësojnë vetëvlerësimin dhe teknologjia i ndihmon për të përmirësuar të nxënit dhe vështirësitë në fushat e tjera. Në këtë mënyrë ata psh. mund të përdorin aplikacione që përmirësojnë dhe lehtësojnë të mësuarit e njohurive sipas fushave të ndryshme.

c. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 6-10 vjeç

Shembulli 1: Aplikacioni im i preferuar

Fëmijët demostrojnë aftësi në përdorimin e aplikacioneve dhe shkëmbejnë përvoja, duke ndihmuar njëri-tjetrin.

Shembulli 2: Me-tube

Fëmijët mësohen se sit ë përdorin kanalin youtube në mënyrë të sigurtë.

Në youtube fëmijët shohin njëdokumentar mbi kafshët (ose të një fushe që ngjall interes për ta) dhe diskutojnë:

- pse interneti është i dobishëm,
- kur ne e përdorim internetin për veprimtari të dobishme,
- dhe si ai na ndihmon për të mësuar njohuri të reja në një mënyrë interesante.

d. Ilustrime dhe ushtrime për fëmijët 10-14 vjeç

Shembulli 1: Fëmijët demostrojnë aftësi në përdorimin e aplikacioneve

- Disa fëmijë 12-14 vjec dalin vullnetarë për të realizuar një poadcast me ndihmën e trajnerëve të fushës;
- Disa fëmijë përgatisin një material në ppt për ishujt e kompetencave;
- Disa fëmijë përpunojnë foto të ndryshme me anë të programeve specifike për foto-editim.

Shembulli 2: Fëmijët kërkojnë informacion për vende të ndryshme.

Diskutim: Si të gjemë informacionin e sigurt?

Poadcasti 1

Poadcasti 2

PJESA III:

Mësime të nxjerra nga nisma

3.1 Si u zbatua nisma "Përdorimi i modelit 'CIAO' për përmirësimin e ishujve të kompetencave të fëmijëve"?

Sikurse u përshkrua edhe në fillim modeli "CIAO" u eksperimentua në kuadër të nismës "Përdorimi i modelit ʻCIAOʻ për të përmirësuar mirëqenien socio-emocionale të fëmijëve", mbështetur nga Terre des Hommes Albania, Child Hub dhe zbatuar nga Shoqata për Trashëgimi dhe Edukim dhe Instituti "Master Thinker" përgjatë periudhës maj-tetor 2021.

19 fëmijë u bënë pjesë e kësaj nisme dhe me ta u zhvilluan 8 workshope, përgjatë të cilëve, u eksploruan ishujt e kompetencave të fëmijëve, duke iu referuar 7 kompetencave të përshkruara në dokumentin e ministrisë së Arsimit dhe Sportit në vitin 2014.

Pas ekspolorimit të ishujve të kompetencës tek fëmijët, u zhvilluan 4 seanca mentorimi, në të cilat u synua orientimi i fëmijëve drejt zhvilimit të ishujve të tyre të kompetencave.

Fëmijët në fillim të kësaj përvoje u bënë pjesë e vlerësimit të mirëqenies socio-emocionale, duke plotësuar pyetësorin e bazuar në modelin IMSE të propozuar nga Bericat, të përshkruar në pjesën e pare të këtij manuali. Ky pyetësor gjithashtu u plotësua edhe pas pothuaj 5 muajsh dhe rezultatet u vunë në krahasim.

Rezultatet evidentuan një ndryshim pozitiv të indeksit të mirëqenies socio-emocionale të fëmijëve që morën pjesë në këtë nismë.

Nga përvoja e pothuaj 6 muajve fëmijët demostruan interes në rritje për të nxënë, për të bashkëpunuar, zhvilluan mendimin kritik, përmirësuan aftësitë krijuese, përforcuan vetëbesimin, shfaqën dëshirëpër të ndarë me të tjerët emocione, mendime, ide dhe nisma.

Zhvilluan ndjenjën e respektit për njeri-tjetrin, për natyrën e mjedisin, përforcuan prirjet për të ilustruar në mënyrë digjitale aftësitë e tyre etj.

Në fund të kësaj nisme fëmijët përgatitën "Ciao Show", ku shpalosën disa aftësi dhe kompetenca nëpërmjet aktrimit, kërcimit, pikturave, këngës, luajtjes në vegla muzikore, etj.

Gjithashtu ata, nëpërmjet dy poadkasteve, dhanë mesazhet e tyre për ndihmën që duhet të marrin nga mësuesit dhe prindërit për të zhvilluar ishujt e tyre të kompetencave.

3.2 Disa sfida të hasura dhe mënyra për t'i kapërcyer ato

1. Në fillim të kësaj nisme, jo të gjithë fëmijët ishin të ndërgjegjshëm për atë çfarë u pëlqente vërtetë të bënin. Disa këtë e ngatërronin me gjërat që kishin mësuar në shkollë,nëpër kurse të ndryshme, ose që prindërit i kishin nxitur për t'ibërë. Për të kuptuar se çfarë vërtetë një fëmijë pëlqen të bëjë, ai duhet të përfshihet në veprimtari të shumta, e të lihet i lirë tëshprehë veten.

2. Të rriturit, nëpërmjet procesit të edukimit, inkurajojnë ose frenojnë shumë aftësi të fëmijëve. Është i nevojshëm ndërgjegjësimi i prindërve dhe mësuesve për të ushtruar më pak presion mbi fëmijët e për t'i lënë ata më të lirë në zgjedhjet dhe zhvillimin e kompetencave në mënyrë të natyrshme.

3. Thuhet se "Suksesi shkon tek të suksesshmit", sepse kur dikush perceptohet si i suksesshëm, ai motivohet dhe promovohet më shumë e, për rrjedhojë, ai vazhdon "të shkëlqejë". Të tjerët qëndrojnë në hije. Identifikimi i duhur i

ishujve të kompetencave të fëmijëve dhe zhvillimi i tyre, rritja e vetvlerësimit dhe vetëbesimit, dhe përmirësimi i mirëqenies së tyre socio-emocionale pa dyshim çon këdo drejt suksesit, në rrugën që çdokush parapëlqen të bëjë në jetë.

4. Kohëzgjatja e kësaj nisme ishte e pamjaftueshme për të zhvilluar një program më të plotë dhe intensiv me fëmijët në lidhje me zhvillimin e ishujve të tyre të kompetencave në funksion të përmirësimit të mirëqenies së tyre socio-emocionale. Mësuesit dhe prindërit kanë përparësinë që të punojnë më gjatë dhe më intensivisht me fëmijët e tyre dhe të vlerësojnëmë objektivisht përparimin e tyre.

Shtojca 1

INDEKSI I MIRËQENIES SOCIO-EMOCIONALE

1. Gjinia
   - Femër
   - Mashkull
2. Mosha:
   - 6-10 vjeç
   - 10-14 vjeç
3. Cikli shkollor
   - Fillor
   - I mesëm i ulët

Përmasa e Mirëqenies Socio-emocionale	Pyetja	Asnjëherë ose pothuaj asnjëherë	Ndonjë herë	Shpesh herë	Pothuaj gjatë gjithë kohës ose gjatë gjithë kohës
Përmasa e gjendjes (emocionale)	Sa shpesh je ndjerë i , e trishtuar në javën e shkuar?	1	2	3	4
	Sa shpesh je ndjerë i / e stresuar gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4
	Sa shpesh je ndjerë i / e vetmuar gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4
Përmasa situacionale	Sa shpesh je ndjerë i / e kënaqur gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4
	Sa shpesh je ndjerë i / e lumtur gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4

Përmasa e fuqisë-energjisë	Sa shpesh je ndjerë i / e shlodhur kur je ngritur në mëngjes gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4
	Sa shpesh je ndjerë i / e qetë dhe paqësor, e gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4
	Sa shpesh je ndjerë plot me energji gjatë javës së shkuar?	1	2	3	4

	Pohimi	**Plotësisht dakord**	**Dakord**	**As dakord as jo dakord**	**Jo dakord**	**Plotësisht jo dakord**
Përmasa personale (vetja)	Në përgjithësi ndihem shumë mirë me veten time.	5	4	3	2	1
	Jam gjithmonë optimist për të ardhmen time.	5	4	3	2	1

Shtojca 2:Ylli i Vetëvlerësimit

Emri_____

Shtojca 3: Vlerat e Mia

Emri im_____

Një vlerë është një besim ose ndjenjë personale se diçka është e rëndësishme dhe e vlefshme.

Mund të jetë diçka që ju pëlqen ta bëni, një mënyrë që ju zgjidhni të jetoni jetën apo edhe një ide.

- Vlerat e mia

- Të marr nota të mira
- Të argëtohem
- Të kaloj kohë me familjen
- Të kaloj kohë me shoqërinë
- Të merrem me sport
- Të krijoj
- Të bej lojra logjike
- Te dal në natyrë
- Të luaj në instrument muzikor
- Të gatuaj
- Të udhëtoj
- Të kujdesem për kafshët
- Të përdor aplikacione dhe software
- Të lexoj libra
- Të eksploroj në internet
- Të mësoj gjuhë të huaja
- Të dëgjoj muzikë
- Të shoh filma
- Të shoh dokumentare të ndryshëm
- Të ndihmoj të tjerët
- Të jem i famshëm
- Të jem i pasur
- Të jem i lirë
- Tjetër_____

Referenca

Për më shumë informacion:

- Bericat, E. (2013). The Socioemotional well-Being Index (SEËBI): Theoretical Frameëork and Empirical Operationalisation. Social Indicators Research, 119(2), 599– 626. doi:10.1007/s11205-013-0528-z

- Lawrence T. Lam and Emmy M. Y. Wong (2017) Enhancing social-emotional well-being in young children through improving teachers' social-emotional competence and curriculum design in Hong Kong. International Journal of Child care and education policy. https://ijccep.springeropen.com/track/pdf/10.1186/s40723-017-0031-0.pdf

- SLawrence, Shapiro (2004) 101 WAYS to teach children social skills. A ready-to use reproducible activity book. The Bureau For At-Risk Youth. https://healthiersfexcel.org/wp-content/uploads/2018/07/101-Ways-to-Teach-Children-Social-Skills.pdf

- Play Today. B.C. Handbook. (2019). British Columbia. Ministry of Education https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/education/early-learning/teach/earlylearning/play-today-handbook.pdf

- National Center on Early Childhood quality assurance (2017. Key Competencies for Licensors of Child Care Programs https://childcareta.acf.hhs.gov/sites/default/files/public/licensor_competencies.pdf

- https://www.betterup.com/blog/What-is-social-well-being-definition-types-and-how-to-achieve-it

- https://chadd.org/adhd-weekly/qa-what-are-islands-of-competence/#:~:text=Ansëer%3A%20The%20idea%20of%20islands,islands%20of%20competence%2C”%20Dr.

- https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf